



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.7.2024

Nr: 76

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
SUBJEKTIT VETËDEKLARUES Z. TONIN ZEF MARINAJ, KRYETAR BASHKIE NË
BASHKINË MALËSI E MADHE, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR
“PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”**

Sot në datën 11.7.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Tonin Zef Marinaj, Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Baza ligjore: Nenet 5, 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe Kryetari i Bashkisë.

Data: 11.7.2024 Nr: 76
Ora: 12:00



“Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Tonin Zef Marinaj, Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

Z. Tonin Zef Marinaj është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si kandidat për Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 02.04.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik SHK-PS-19163. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Tonin Zef Marinaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ, DPB informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

- (1) Me vendimin nr. 618, datë 25.05.2023, të KSHZ-së, z. Tonin Zef Marinaj, i është dhënë mandati i Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- (2) Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 2547 prot., datë 28.06.2024, nëpërmjet së cilës i kërkon verifikim të thelluar për z. Tonin Zef Marinaj.
- (3) Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën 860/1, datë 03.07.2024, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në të cilën pretendohet se subjekti z. Tonin Zef Marinaj, si kandidat për Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në kundërshtim me ligjin, në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar të dhënat që lidhen me:
 - Hetimin në kuadër të procedimeve penale nr.1615/2010, nr.14109/2010 dhe nr.15892/2011.10 RGNR mod.21, si dhe gjykimin e tij me kërkesën datë 29 mars 2016, nga Prokuroria dhe Gjykata e Shkallës së Parë në Firencë të Italisë, për kryerjen nga data 23.05.2010 - 23.7.2010, të trafikimit të lëndës narkotike të llojit mariuanë.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

V E N D O S :

Data: 11.7.2024 Nr: 76
Ora: 12:00



“Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Tonin Zef Marinaj, Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Tonin Zef Marinaj, Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 11.7.2024 Nr: 76
Ora: 12:00



“Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Tonin Zef Marinaj, Kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”